

Shoqata për Administrimin Kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të drejtave të përfaqësuara, Autorët Vizualë, Producentët dhe Interpretuesit e Kosovës "VAPIK", në bazë të Nenit 102 të Ligjit Nr. 08/L-205 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përfaqësuara, dhe në bazë të Vendimit Nr. 13/38 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 30.10.2020, dhe Vendimit Nr. 12/36 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 19.10.2020, në mbledhjen e datës 26.03.2024 ka marrë këtë:

## VENDIM

-Për caktimin e tarifave mujore për shfrytëzimin e lëndës së mbrojtur me rastin e ritransmetimit për vitin kalendarik 2025.

Tarifat mujore për shfrytëzimin e lëndës së mbrojtur me rastin e ritransmetimit për vitin kalendarik 2025 për kompensim, janë bazuar për grupet e kanaleve televizive të ritransmetuara të cilat janë kategorizuar sikurse në vijim:

- Deri në 70 TV kanale , 0.30 euro për abonues;
- Nga 71 deri në 100 TV kanale, 0.35 euro për abonues;
- Nga 101 deri në 150 TV kanale 0.40 euro për abonues;
- Mbi 151 TV kanale, 0.45 euro për abonues;

## ARSYETIM

Autorët Vizualë, Producentët dhe Interpretuesit e Kosovës – VAPIK), është e licencuar në Zyrën për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përfaqësuara në Republikën e Kosovës si shoqatë për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përfaqësuara. Kjo shoqatë përfaqëson Autorët Vizualë, Producentët dhe Interpretuesit në Republikën e Kosovës.

Në bazë të lejes të lëshuar nga Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përfaqësuara, të datës 11.07.2012, VAPIK bën administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përfaqësuara për të drejtat e ritransmetimit kabllor dhe të drejtat e transmetimit nga shërbyesit medial audiovizual.

VAPIK në emër të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përfaqësuara për të drejtat e ritransmetimit kabllor dhe të drejtat e transmetimit nga shërbyesit medial audiovizual, gëzon të drejtën e mbledhjes së tarifave të përcaktuara nga operatorët kabllorë dhe subjektet e tjera, të cilat do të kompensohen në emër të së drejtës së ritransmetimit, dhe të njëjtat më pas do tu shpërndahen bartësve të të drejtave, në bazë të së drejtave autoriale, të garantuara me ligjet në fuqi.

Operatorët e licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave, janë të obliguar të transmetojnë dhe ritransmetojnë programet në bazë të marrëveshjeve të vlefshme për të drejtën e autorit të lidhura dhe të regjistruara me VAPIK, dhe që kësaj shoqate t'ia paguajnë tarifën mujore për shfrytëzimin e lëndës së mbrojtur me rastin e ritransmetimit, në bazë të shumave të përcaktuara si më lartë.


Me rastin e përcaktimit të tarifave, VAPIK me kujdes ka marrë parasysh dhe ka shqyrtuar të gjitha kriteret e përcaktuara me Paragrafin 2 dhe Paragrafin 5 të Nenit 102 të Ligjit Nr. 08/L-205 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, dhe ka marrë për bazë Vendimet Nr. 12/36 dhe Nr. 13/38 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 19.10.2020, dhe datës 30.10.2020.

Lartësia e tarifave është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkundër vërejtjeve të VAPIK që të jenë më të larta. Edhe se tarifat e përcaktuara me këtë vendim janë shumë nën mesataren e rajonit, por VAPIK vazhdon të angazhohet që të harmonizoj tarifat me rajonin dhe të arrij kompensim të denjë për mbajtësit e të drejtave, ndonëse e ritheksojmë se të njëjtat nuk janë përcaktuar duke qenë në proporcion të drejtë me shkallën e lartë të inflacionit vendor e as nuk është marr parasysh kësaj radhe fakti se nga viti 2020 e deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi operatorët kabllor kanë rritur dukshëm çmimet për pakot e njëjta kabllore.

Megjithatë, tarifat e përcaktuara në këtë mënyrë, kanë për synim stimulimin e realizimit të tërësishëm të kompensimit, në emër të shfrytëzimit të lëndës së mbrojtur me rastin e ritransmetimit.

Vendim hyn në fuqi nga data 31.03.2024, dhe të njëjtin mund ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Organizatës së Menaxhimit Kolektiv "VAPIK" si dhe për këtë vendim njoftohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi..

Prishtinë, 26.03.2024.



Drejtor i Bordit